



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "linden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 132** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 28.08.2018 deri më 11.09.2018.

Tetovë, më 28.08.2018



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE - RIZGJEDHJE TË
MËSIMDHËNËSVE NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE NË
UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Me propozim-vendim të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës nr. 14-703/3 të datës 12.06.2018, dhe vendim të Këshillit të Rektoratit nr.02/2617/1, të datës 20.06.2018, dhe në bazë të konkursit të shpallur më: 04.06.2018 në gazetata ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija”, është caktuar komisioni recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi, për lëndët: **Menaxhmenti Financiar** dhe **Financa Publike**, (në programet studimore: Ekonomi Biznes, Financa dhe Kontabilitet, Marketing – Menaxhment, Biznes Ndërkombëtar dhe Turizëm), në përbërje:

1. Prof. dr. Alifeta Selimi, kryetar;
2. Prof. dr. Etem Iseni anëtar;
3. Prof. dr. Afrim Alili, anëtar,

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë vërtetoi se kanë aplikuar dy kandidat për zgjedhje të një mësimdhënësi, për lëndët Menaxhment Financiar dhe Financa Publike, dhe pasi që dosja e aplikimit përmban të gjithë dokumentacionin e paraparë në konkurs, vendos që të paraqet këtë:

Raport recensues

Me datë 04.06.2018 në gazetata “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur konkurs për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin Ekonomik, në thirrjen mësimore shkencore, për lëndët: Menaxhment Bankar dhe Financa Publike (në programet studimore: *Ekonomi dhe Biznes, Financa dhe Kontabilitet, Marketing – Menaxhment, Biznes Ndërkombëtar dhe Turizëm*). Komisioni recensues konstaton se në konkurs janë paraqitur dy kandidat;

1.dr Sherif Abdullahi

2.dr Gjilnaipe Bexheti

I.TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE NGRITJA PROFESIONALE

1. Dr. Sherif Abdullahi aktualisht i punësuar në Ecolog International Middle East LLC for Qatargas, Doha, Katar, si koordinator i projekteve, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Nga

dokumentacioni i dorëzuar, titujt shkencorë Magjistër i Shkencave të Financave Islame dhe Doktor i Shkencave të Ekonomisë dhe e Drejta Ekonomike, nuk janë të nostrifikuara.

Në konkursin e shpallur, kandidati ka paraqitur dokumentacion të notarizuar.

dr. Sherif Abdullahi, i lindur më 22.06.1979 në Tetovë. Studimet bazike i ka përfunduar në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë në Fakultetin e Biznes Administrimit-drejtimi financa. Studimet e magjistraturës i ka përfunduar në vitin 2011 në INCEIF-THE GLOBAL UNIVERSITY IN ISLAMIC FINANCE, titulli *Master in islamic finance*.

Kandidati në vitin 2017, merr titullin shkencor *Doctor of Philosophy in Economics and Muamalat Administration* në USIM-ISLAMIC SCIENCE UNIVERSITY OF MALAYSIA.

II .VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Sipas listës së bashkangjitur për veprimtarinë shkencore-hulumtuese , kandidati ka realizuar ka realizuar këto dy publikime:

1.Sherif ABDULLAHI, Amir SHAHARUDDIN, “Potential for Islamic Banking in Macedonia: An Empirical Evidence”, International Review of Management and Marketing, Turkey

2.Sherif Abdullahi, Amir Shahuiddin “Knowledge and Awareness of Islamic Banking and Finance in Macedonia: An Empirical Evidence, Journal of Global Business and Social Entrepreneurship(GBSE) 2016

2. Dr. Gjilnaipe Bexheti.

1. Të dhëna biografike dhe ngritja profesionale

Kandidatja Dr Gjilnaipe Bexheti është lindur më 16.12.1959 në fshatin Pirok.Shkollimin e mesëm e mbaron në vitin 1978 në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” të Tetovës, drejtimi i Përgjithshëm. Studimet bazike i kryen në Fakultetin Ekonomik, Univerziteti i Prishtinës në vitin 1982 –Prishtinë.

Po në të njëjtin institucion në vitin 2002 regjistron studimet e magjistraturës në drejtimin – financa.Në vitin 2007 pasi që i kryentë gjitha provimet mbron me sukses temën e magjistraturës me titull: **Ndërvarësia Midis Sektorit Privat dhe Kapitalit të huaj në Kompanitë e Maqedonisë me theks të veçantë në Maqedoninë Perendimore** dhe fiton gradën shkencore *Magjistër i shkencave ekonomike*.

Gjilnaipe Bexheti në vitin 2014 ka marrë gradën shkencore Doktor i shkencave ekonomike, në Fakultetin e Biznesit, Universiteti i Europës Juglindore Teza e disertacionit: „**Sfidat e Etikës Menaxheriale dhe Përgjegjsia Shoqërore në Kompanitë e Maqedonisë**“

Nga viti 2011 është pjesë e stafit të angazhuar në kohë të caktuar në Fakultetin Ekonomik, në Univerzitetin e Tetovës në lëndët: Menaxhment Financiar, Financa Publike, Menaxhment Bankar, Sjellja Konsumatore, Marketingu i Shërbimeve, Komunikimi në Biznes.

Përvojën e pare profesionale e ka filluar në vitin 1983 në kombinatin e tekstit “TETEKS” deri në vitin 1990. Nga viti 1990 me liberalizimin e tregut punon në sektorin privat si drejtues i financave deri në vitin 1998. Nga viti 1998 deri në vitin 2002 punon në SHA “MAKEDONSKI TELEKOM” Shkup, si ndihmës drejtor për ekonomi kurse nga viti 2003 deri në vitin 2013 në sektorin financiar si SAP kontrollor në SHA “MAKEDONSKI TELEKOM” në Shkup.

Nga viti 2013 deri në momentin aktual, e evidentuar si e papunë në Agjensionit e Punësimit në Maqedoni.

2. Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore

Aktivitetin mësimor në Universitet e ka filluar në Fakultetin Ekonomik, Univerziteti i Tetovës që nga viti 2011 si asistente në studimet deri diplomike në lëndët: Menaxhment Financiar, Financa Publike, Menaxhment Bankar, Sjellje konsumatore, Komunikimi në Biznes.

Në mbështetje të nenit 144 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Univerzitetin e Tetovës (Buletini i Universtit), kandidatja dr. Gjilnaipe Bexheti ka realizuar gjithsej 139 pikë nga veprimtaria arsimore (shtojca).

3. VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE

Nga analizimi i dosjes konstatohet se ka një aktivitet të gjerë kërkimor-shkencor i cili mund të përmblihet në këto drejtime:

3.1 Pjesëmarrja në konferenca /Botime dhe artikuj shkencorë

Që nga viti 2011, kohë kur dr. Gjilnaipe Bexheti ka filluar punë si lektore me kohë të caktuar, është angazhuar në konferenca me punime të vlerësuara si të rëndësishme. Pas mbrojtjes së doktoraturës ka vazhduar angazhimin në veprimtari kërkimore e shkencore. Në periudhën pas doktoraturës në mënyrë aktive ka marrë pjesë si pjesëmarrëse në aktivitete shkencore, simposiume, konferenca ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit Nga konferencat e përmendura 8 janë zhvilluar pas marrjes së titullit Doktor i Shkencave (Ph. D.). Pas shqyrtimit të dosjes së paraqitur nga dr. Gjilnaipe Bexheti, më poshtë paraqitet përmbledhja e artikujve të botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit tabela tabela 1.

Në periudhën 2011-2018 ka botuar katër artikuj shkencor në revista ndërkombëtare në Revista me faktor impakti. Përsa i përket punimeve shkencore të paraqitura në konferenca, boshti i tyre kanë qënë tema të shkencave ekonomike.

Tabela 1. Pjesëmarrja në Konferenca Botime dhe artikuj shkencorë

Nr	Emërtimi i Konferencës/ Revistës	Titulli i Konferencës/ Titulli i Artikullit	Koha, Vendi
1	International Conference: Knowledge in Practice	Factors Determining Innovation: Evidence From Macedonia”	(2017, Bansko)
2	EUREM	“Gender Equality in the Labor Market: a challenging path of Republic of Macedonia toward EU”,	(2016, Moldova)
3	4th International Scientific Conference: "The economic Effects of Migration Process in the Western Balkans"	"Menaxhimi i potencialit të diasporës në funksion të zhvillimit ekonomik –rasti i Maqedonisë"	(2016, Tetova)
4	BAS	Менаџирање на онлајн репутацијата преку социјалните медиуми,	(2016, Manastir)
5.	V th INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE: KNOWLEDGE-CAPITAL OF THE FUTURE,	Corporate Social Responsibility and Employee Satisfaction-Case of Republic of Macedonia,	(2015, Bansko)
6	Thirrd International Scientific Conference " Environmental Factors, Challenges for Economic Development"	" Internet Broadband determinants in SME's"	(2015, Dhjetor) Tetova
7	1-st ANNUAL CONFERENCE ON SOCIAL ENTREPRENEURSHIP PERSPECTIVES	The importance of innovation in Corporate Social Responsibility (CSR)	(2011, Linc-Austri)

3.2 BOTIME MËSIMORE

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë kërkimore-shkencore gjatë periudhës së kaluar, e cila është me domethënie të veçantë për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të kandidatës. Në mbështetje të nenit 144 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës (Buletini i

Universitetit), kandidatja Dr. Gjilnaipe Bexheti ka realizuar gjithsej 41 pikë nga veprimtaria kërkimore-shkencore .

4. Veprimtaritë me interes më të gjerë

Në mbështetje të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr. Gjilnaipe Bexheti ka realizuar gjithsej 5 pikë nga veprimtaritë me interes më të gjerë .

VI. Formulari në bashkëngjitje të Raportit për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore

Në shtojcë e paraqesin formularin në bashkëngjitje të Raportit për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore. Kandidatja dr. Gjilnaipe Bexheti ka gjithsej 165,2 pikë, edhe atë: veprimtaria mësimore 119,2 pikë, veprimtaria kërkimore-shkencore 41 pikë, , veprimtaritë me interes më të gjerë 5 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA ARSIMORE	119,2
VEPRIMTARIA KËRKIMORE – SHKENCORE	41
VEPRIMTARTË ME INTERES MË TË GJERË	5
Gjithsej	165,2

Në mbështetje të nenit 21 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin E Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja dr. Gjilnaipe Bexheti ka realizuar gjithsej 165,2 pikë dhe e ka realizuar numrin e pikëve që duhet të realizohet për zgjedhje në thirrjen docent.

Përfundim dhe propozim

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja dr. Gjilnaipe Bexheti në përputhje me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, shkencore-hulumtuese dhe të bashkëpunotrit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit) ka tubuar gjithsej 165,2 pikë nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhje në thirje mësimore shkencore DOCENT.

Në bazë të dokumentacionit që shoqëron aplikimi i kandidatës komisioni mendon se kemi argumente bindëse për të mbështetur vendiminin tonë për propozim Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që dr.Gjilnaipe Bexheti të zgjidhet në thirjen mësimore docent për lëndët: Menaxhment Financiar dhe Financa Publike pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, më _____

Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Alifeta Selimi, kryetar;

2. Prof. dr. Etem Iseni, anëtar;

3. Prof. dr. Afrim Alili, anëtar.

**SHTOJCË PËR RECENSIONIN PËR ZGJIDHJEN NË THIRJEN MËSIMORE
SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

KANDIDATI: GJILNAIPE IBRAHIM BEXHETI

INSTITUCIONI: FAKULTETI EKONOMIK, Univerziteti i Tetovës , TETOVË

LËMIA SHKENCORE: MENAXHMENT FINANCIAR DHE FINANCA PUBLIKE

1. VEPRIMTARIA MËSIMORE -ARSIMORE

Nr.	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	PIKËT	TOTAL
1	MBAJTJA E LIGJERATAVE		
a	CIKLI I PARE I STUDIMEVE	0.03	
	SJELLJA KONSUMATORE	15*0.03*50 15*0.03*50	2,25 2.25 =4.5
	MENAXHMENTI FINANCIAR	6*15*0.03*35 6*15*0.03*35	9.45 9.45 =18,9
	MARKETINGU I SHËRBIMEVE	15*0.03*60	2,7
	KOMUNIKIMI NË BIZNES	3*15*0.03*30 3*15*0.03*30	4.05 4.05 8.10
	MENAXHMENTI BANKAR	5*15*0.03*50 5*15*0.03*50	11,25 11.25 22.5
	FINANCA PUBLIKE	5*15*0.03*120 5*15*0.03*120	27 27 =54
	TOTALI		110.7
a	LIGJERATA	1	6*1= 6
b	USHTRIME	0.5	5*0.5= 2.5
	TOTALI		8.5

II VEPRIMTARIA SHKENCORE- HULUMTUESE

	VEPRIMTARIA SHKENCORE- HULUMTUESE		
	PUNIM ME REZULTATE SHKENCORE ORIGJINALE, I PUBLIKUAR NE REVISTE SHKENCORE PROFESIONALE		
	2016 "Gender Equality in the Labor Market: a challenging path of Republic of Macedonia toëard EU", EUREM, R. of Moldova		
	2016 "MENAXHIMI I POTENCIALIT TË DIASPORËS NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK –rasti i Maqedonisë"", Gj. Bexheti, 4th International Scientific Conference: "The economic Effects of Migration Process in the Ëestern Balkans" Tetova, R. Macedonia		4 4 4 4 4
14	2015 " ", Gj. Bexheti et.al, Thirrd International Scientific Conference "	4	=20

	<p>Environmental Factors, Challenges for Economic Development", Tetova, R. Macedonia</p> <p>2014 Evidence On R&D Predictors. The Case Of Macedonia And Albania, B.Xhaferi,J.Musliu, Gj.Bexheti, "Regionl Ecobomic Cooperation in the process of Globalization,Tetovë</p> <p>„ Investments as a Precondition for successful Restructuring of the Macedonian Economy“Mr A.Bexheti&Gj.Bexheti medjunarodna konferencija 12-13 tetor, , Sarajevë,</p>		
15	<p>PUNIM ME REZULTATE SHKENCORE ORIGJINALE, I PUBLIKUAR NE REVISTE SHKENCORE PROFESIONALE ME BORD NDERKOMBETAR</p> <p>“Factors Determining Innovation: Evidence From Macedonia” Gj. Bexheti et al, International Conference: Knowledge in Practice, Bankso, Bulgaria, p871-875, 2015 Gj.Bexheti, V th INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE: KNOWLEDGE-CAPITAL OF THE FUTURE,Title:CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY AND EMPLOYEE SATISFACTION-CASE OF REPUBLIC OF MACEDONIA, , Bulgaria</p> <p>-Gj.Bexheti&S.Kurtishi&G.Rexhepi 1-st ANNUAL CONFERENCE ON SOCIAL ENTREPRENEURSHIP PERSPECTIVES”: “The importance of innovation in Corporate Social Responsibility (CSR) –08.2011 Linc-Austri.</p>	6+ IF	6 6 6 =18
17	<p>PUNIM ME REZULTATE SHKENCORE ORIGJINALE NE REVISTE TE NJOHUR SHKENCORO-PROFESIONALE ME BORD EDITORIAL NDERKOMBETAR</p> <p>2016 Менаџирање на онлајн репутацијата преку социјалните медиуми, Gj. Bexheti et al, Manastir</p>	3	3
	TOTALI		41

3. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PIKET	
18	PRODEKAN/ZEVENDES DREJTOR	4	4
27	PJESMARËS NË KOMISIONE DHE TRUPA TË ORGANEVE SHTETËRORE DHE TJERA	1	1

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE	Poenë
VEPRIMTARIA ARSIMORE	119,2
VEPRIMTARIA KËRKIMORE – SHKENCORE	41
VEPRIMTARTË ME INTERES MË TË GJERË	5
Gjithsej	165,2